Deklaroj se zotëroj mjetet pajisjet teknike dhe asete të tjera fizike për të realizuar kontratën me objekt: _____

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Dhe

Me qera					Afati i kontratës së qerasë (Data e fillimit dhe mbarimit)
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes së qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	
1					
2					
3					
4					
5					
6					

- shto/fshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.

Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhënë në këtë tabelë.

PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)

Emri:

Adresa:

Nr. Telefonit:

Faks:

E-mail:

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik)

DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCËS⁴

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës se prokurimi/kontratës	Vlera e shpallur fituese

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

⁴ Kjo deklarate ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*
- c. *Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*
- ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*
- e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*
- f. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*
- g. *Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*
- gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme për praninë.

2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjatë tre viteve të fundit 2017, 2018 dhe 2019, duhet të mos jetë më e vogël se 50% e fondit limit të procedurës së prokurimit. Për të vertetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga Dega e Tatimit Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit.

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të tre viteve të fundit 2017, 2018, 2019, të paraqitura pranë autoritetit përkatës, të konfirmuara nga ky autoritet, në të cilat duhet të rezultojë se nuk ka dale me humbje të pakten në dy vite të njëpasnjëshme.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori i subjektit ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për periudhën vitet 2019 dhe të vitit 2020 sipas ligjit Nr. 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Kësaj deklarate duhet të bashkëngjiten të gjithë vërtetimet që dëshmojnë se operatori ekonomik **ka paguar detyrimet përkatëse**, në vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për këtë periudhë.

*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

*Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e informacionit të paraqitur. Në rast deklarimi të rreme do të vepohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Për Prokurimin Publik".

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori/et Ekonomik duhet të përmbushë/in kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën :

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm **në një vlerë jo më të vogël se 50%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar nga operatori ekonomik gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.
- ose**
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është **në një vlerë jo më të vogël se** dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

-Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë punët sipas tabelës së mëposhtme:

NR	OBJEKTI I KONTRATES	DATA E FILLIMIT	DATA E PERFUNDIMIT	VLERA PA TVSH	VLERA E REALIZUAR NE 3 VITET E FUNDIT

-Ngjashmëria e kontratave do të bazohet në natyrën, kompleksitetin dhe/ose karakteristika të tjera të përshkruara në raportin teknik.

Vlerësimi i përvojes së suksesshme të Operatori/et Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:
 1. Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 2. Kontratën/at e Sipërmarrjes
 3. Situacionin përfundimtar të objektit;
 4. Fatura tatimore për situacionin përfundimtar te punimeve
 5. Akt kolaudimi;

Formulari i vlerësimit duhet te percaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes se punëve, faktin nëse kontrata eshte realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj

- ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

Dokumenta Standarde të Tenderit

1. Formular vleresimi per realizimin e punimeve, shoqëruar me:
2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
3. Situacionin përfundimtar të objektit;
4. Fatura tatimore për situacionin përfundimtar te punimeve.
5. Akt kolaudimi

Pika 2.3.1 gërma a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit;

Per kontratat e realizuara si Nenkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- Kontrata baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe
- Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë nje punësim mesatar i të paktën **60 (gjashtëdhjetë)** punonjës për periudhën Nentor 2020 – Janar 2021, e vërtetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqerore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Nentor 2020 – Janar 2021.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Nentor 2020 – Janar 2021.

**Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në grafikun e punimeve, preventivin dhe orët e punës që duhet për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje Nentor 2020 – Janar 2021, tregon besueshmëri për autoritetin.*

2.3.3 Staf kryesor e mbeshtetes, punonjesit, çertifikimet

- a. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga administratori) stafin teknik të shoqërisë, si më poshtë:

Numri	Pozicioni
Stafi Kryesor i perfshire ne licensen e shoqerise	
1 (një)	Inxhinier Ndërtimi
1 (një)	Inxhinier Hidroteknik

1 (një)	Inxhinjer Elektrik
1 (një)	Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik
1 (një)	Inxhinier Mjedisi

b. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ certifikuar si:

- **2 (dy)** Inxhinierë nga Stafi Kryesor i perfshire ne licensen e shoqerise të disponojnë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".
- **1 (nje)** inxhinier per punimet e instalimit dhe saldimit te tubove Plastike qe duhet të kryhen nga personeli i trajnuar dhe me pervoje (jo me pak se nje vit) I certifikuar me certifikata personale të saldimit për saldimit e bashkimit sipas standardit të harmonizuar të BE-së EN 13067: 2014, leshuar nga nje organizem certifikimi i pavarur i njohur nga sistemet e standartizimit kombetar ose nderkombetar.
- **1 (një)** Inxhinier i paisur me “Certificate Per Audituesin Energjitik”, Auditues energjitik ne ndertesa dhe instalime industriale, leshuar nga M.I.E. në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 124/2015 “PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË”
- **1 (një)** Inxhinier Mekanik

**Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merrem masa për ndërprerjen e kontratës dhe deri në propozimin në Agjencinë e Prokurimit Publik për marrje masash ndaj operatorëve ekonomikë.*

Si dëshmi për stafin e mësipërm të paraqiten dokumentet si më poshtë:

- Kontratë individuale të punës
- Diploma/Certifikata
- CV
- **Stafi kryesor i inxhinierëve - të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Nentor 2020 – Janar 2021**

Operatori Ekonomik duhet te deklaroje me shkrim se inxhinieret dhe punonjesit e kerkuar ne piken 2.3.3/a, jane te paangazhuar ne kontrata te tjera.

2.3.4 Operatori/et ekonomike ofertues duhet të kenë të punësuar si staf teknik punonjës nga të cilët të jenë:

- ✚ **2 (dy)** teknik ndertimi

- ✚ 4 (kater) pllaka shtrues
- ✚ 5 (pese) karpentier
- ✚ 2 (dy) hidraulike
- ✚ 2 (dy) elektriciste
- ✚ 8 (tete) shofere
- ✚ 14 (katermbedhjete) manovratore

Për secilin duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës
- Dëshmi Kualifikimi të Sigurimit Teknik e lëshuar nga ISHTI ose nga një trup çertifikuese e akredituar në Republikën e Shqipërisë.
- Secili prej tyre duhet të figurojë në listëpagesën e shoqërisë **minimalisht 3 muajt e fundit**.

Për Teknik të mesëm ndërtimi duhet të paraqiten edhe:

- Diploma ose dëshmi e përfundimit të kualifikimit përkatës.

Për Hidrauliket dhe elektricistet duhet të paraqiten edhe:

- Çertifikatë e Kursit të Unifikuar/hidraulik lëshuar nga Institucione ofruese të formimit profesional të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 15/2017 dt 16.02.2017 për “Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë” si dhe Ligjit Nr. 10 247, Datë 4.3.2010, “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve” I ndryshuar

Për manovratorët dhe shoferet të paraqitet edhe:

- Dëshmi aftësie profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë të lëshuar nga DPSHTRR/ Për shoferet, leja e drejtimit në përputhje me kategorinë e mjetit, lëshuar nga DPSHTRR

Ndërsa për 14 (katermbedhjete) Punetore ndërtimi të thjeshtë, të paraqitet një vetëdeklarim nga shoqëria, ku listohen si punëtorë të thjeshtë ndërtimi, listpagesa sipas formularëve standard për sigurimet, për 3-muajt e fundit, të cilit i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës. Dokumenta të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit në fuqi (nëpërmjet formës elektronike).

2.3.5 Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij 1(një) mjek në bazë të paragrafit 12/2 të VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 “Për Masat e Vecanta të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë, i ndryshuar dhe të Ligjit Nr.10237, datë 18.02.2010 ”Për sigurinë dhe shëndetin në punë”,

*Ose/sipas VKM Nr.108, datë 09.02.2011, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarresit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me ceshtjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë“, i ndryshuar, ku parashikohet se, nëse punëdhënësit nuk kanë personat e ngarkuar

përgjegjës, me aftësi dhe kualifikimet e duhura për të realizuar detyrat lidhur me çështjet e shëndetit në punë, mund t'i sigurojnë këto shërbime me anë të marrëdhënieve kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.

Për të cilin duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës e vlefshme
- Diplomë
- Urdhër Mjeku

**Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.(Në mbështetje të VKM Nr. 692 datë 13.12.2001 ndryshuar me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003 “Për masat e vecanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, Neni 12/1 Operatorët ekonomik pjesmarrës që kanë të punësuar më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës nuk kanë detyrim ligjor plotësimin e kërkesës së mësipërme.)*

2.3.5 Operatori/et ekonomike ofertues duhet të disponojnë licensat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën perkatese të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”. Shqyrtimi i licensave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDERTIMI

- N.P – 1. A Punime gjurmimi në tokë.
- N.P – 4. C Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
- NP – 5 A Punime nentokësore, ura e vepra arti
- N.P – 7. A Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi dhe vaditje.
- N.P – 12. A Punime të inxhinierisë së mjedisit.

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

- N S – 1. A Punime për prishjen e ndertimeve
- N.S – 6. A Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
- N S – 18 A Punime topogjeodezike

**Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.*

2.3.6 Operatori/et ekonomike ofertues duhet te disponoje dhe paraqese çertifikatat te vlefshme si me poshte:

- **ISO 9001-2015** (Sistemi i menaxhimit te cilesise), ose ekuivalente
- **ISO 14001-2015** (Sistemi i menaxhimit të mjedisit), ose ekuivalente
- **ISO 45001-2018**, (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë), ose ekuivalente
- **ISO 39001 -2012** (Sistem i menaxhimit te sigurisë rrugore dhe trafikut), ose ekuivalente
- **PAS 99:2012** (Sistemi i integruar i menaxhimit) ose ekuivalente

*** Te gjitha certifikata e mesiperme duhet te jene te lëshuara** nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Pranoen edhe standarde Shqiptare SSH/EN: SSH/ISO mbi komformitetin e standardit europianapo atij ISO dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

**Nese ofertuesi do te paraqitet si bashkim operatoresh, certifikatat ose ekuivalente duhet te jene ne perputhje me perqindjen e pjesemarrjes ne pune.*

2.3.7 Operatori/et ekonomike ofertues duhet te disponoje dhe paraqese **Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi/qira/kontratë furnizimi: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.**

**Mjetet dhe numri i tyre është përcaktuar bazuar në grafikun e punimeve, preventivin dhe orët e punës që duhen për të përmbushur kontratën.*

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 7.5-20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 4
2	Kamion me vinç dhe vetëshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Kamionçine me kapacitet mbajtës deri ne 1.5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
4	Grejder	në pronësi ose me qira	Copë 2
5	Rrul me vibrim deri ne 10.5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
6	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 2
7	Autobitumatriçe	në pronësi ose me qira	Copë 2
8	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Copë 2
8	Fadrome me goma,kove perpara dhe mbrapa	në pronësi ose me qira	Copë 2
9	Eskavator me zinxhire me peshe nga 15-24 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1

Dokumenta Standarde të Tenderit

10	Eskavator me goma me peshe nga 15-24 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
11	Automjet vijezi me boje termoplastike me kapacitet jo me te vogel se 4.5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
12	RTV-Transportier mjete te rrenda	në pronësi ose me qira	Copë 2

- a) Te gjitha mjetet e mësiperm të jenë të regjistruar në regjistrat publikë dhe të paraqiten dokumentat e mëposhtëme:

Për mjetet në pronësi:

1. Leje qarkullimi (e vlefshme)
2. certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
3. Police sigurimi (e vlefshme)
4. Çertifikate “Per transport mallrash brenda vendit per llogari te vete”, te leshuar nga Bashkia ne te cilen ushtron aktivitetin (e vlefshme)

Për mjetet me qira:

1. Kontrata përkatëse noteriale e qirasë, ku të jetë i përcaktuar objekti i këtij prokurimi, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
2. Leje qarkullimi (e vlefshme)
3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
4. Police sigurimi (e vlefshme)
5. Çertifikate “Per transport mallrash brenda vendit per llogari ne te trete”, te leshuar nga Bashkia ne te cilen ushtron aktivitetin (e vlefshme)

Nr	Lloji i Makinerive/Paisje	Perkatesia	Sasia
1	Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 2
2	Paisje per sperkatje bitumi	në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Matrapik-Cekic hidraulik	në pronësi ose me qira	Copë 2
4	Betoniere	në pronësi ose me qira	Copë 4
5	Freze asfalti	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Prerëse asfalti	në pronësi ose me qira	Copë 2
7	Minieskavator	në pronësi ose me qira	Copë 2
8	Minifadromë (Bobcat ose ekuivalent)	në pronësi ose me qira	Copë 2
9	Armature	në pronësi ose me qira	Mbi 300 m2
10	Makineri për vijëzim rrugor	në pronësi ose me qira	Copë 1
11	Vibrator betoni	në pronësi ose me qira	Copë 2
12	Paisje per ngjitje plastike HDPE	në pronësi ose me qira	Copë 1
13	Fabrikë Asfaltobetoni, e pajisur me QKL, leje mjedisore	në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi	Cope 1

- b) Për mjetet dhe paisjet e mesiperme që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

Dokumenta Standarde të Tenderit

- c) Për mjetet dhe paisjet e siguruara me qira,që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre,aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes, duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse noteriale të qirasë/furnizimit, ku të jetë i përcaktuar objekti i këtij prokurimi, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi
- d) Për fabriken e asfaltobetonit, nese eshte ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes/çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, leja mjedisore Kodi III 1 B lëshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit,si dhe plan vendosja e instalimit te paisjes per vendndodhjen e saj. Nese eshte marre me qira/furnizim krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qirasë/furnizimit, ku të jetë i përcaktuar objekti i këtij prokurimi, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi
- e) Per fabriken e asfaltobetonit, Mbështetur në VKM nr.628 datë 15.7.2015 “Për miratimin e rregullave teknike dhe ndërtimit te rrugeve”, nga koha e prodhimit, transportit, shtrimit nuk duhet qe te kaloje me shume se 2 ore, fabrika e asfaltit bazuar ne vendimin e sipercituar nuk duhet te jete me larg se 70 km nga objekti i prokurimit.
- f) Mjete dhe paisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 si më poshtë vijon:
- Kokore minimumi 60 cope
 - Fikse zjarri te levizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 10 cope,
 - Prozhektore ndricimi naten minimumi 4 cope,
 - Komplet i ndihmes se shpejte minimumi 10 cope,
 - Tabela paralajmeruese per sigurine ne objekt minimumi 20 cope
- g) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme ne nje foto te vetme mjete dhe targa e tij.
- h) **Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te vepohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa” a” te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Per Prokurimin Publik”.**

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- a) PLAN - ORGANIZIMIN e punimeve të objektit ku te reflektoje te gjitha masat tekniko-organizative dhe elementet e tjere qe kerkon nje plan organizimi i mirëfilltë.
- b) PLANIN E SIGURISE NE KANTIER per punimet ne objekt ne format sipas VKM nr. 692 date 13.12.2001 “Per masat e vecanta te sigurimit dhe ruajtjes se shendetit ne pune, te ndryshuar me VKM nr. 742 date 06.11.2003”, sipas kerkesave, si rrethimi provizor, depozitimi i materialeve kryesore, ambientet e kantierit, rruge kalimet, tabelat e sig. teknik etj.
- c) GRAFIKUN E PUNIMEVE në përputhje me afatin e realizmit të punimeve.

2.3.9 Operatorët e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës), të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuar “Apostile”. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, “Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës.

2.3.10 Kandidatët/ofertuesit duhet të përmbushin kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 45 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”i ndryshuar. Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, kandidatët/ofertuesit duhet t’i përmbahen VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.11 Nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik, duhet të dorëzohen marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht dhe Prokura e posaçme. Çdo anëtar i grupit, duhet të dorëzojë dokumentat e kerkuara, në perpjestim dhe përputhje me punët e marra për sipër sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

2.3.12 Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “*periudhë*” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektit etj:
Bashkengjitur DST

Specifikimet Teknike të Materialeve:
Bashkengjitur DST

Grafiku i Punimeve:
Bashkengjitur DST

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Bashkengjitur DST

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁵

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

⁵ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e

Dokumenta Standarde të Tenderit

shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____

Shtojca 18

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokures.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

Dokumenta Standarde të Tenderit

- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit

të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

